



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b), c) dhe g), ndërlidhur me nenin 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2) 1.3) dhe 1.7) ndërlidhur me nenin 64 paragrafët 3 dhe 4 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, jep këtë:

A U T O R I Z I M

Autorizohet z. Driton Veliu, U.D. Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Podujevë, që në emër të Komunës së Podujevës, të nënshkruaj Marrëveshje me Policinë e Kosovës - përfaqësuesin e Policisë për ofrimin e shërbimit për mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike në objektin e urgjencës në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF në Podujevë, konform draftit përkatës të Marrëveshjes, bashkëngjitur këtij autorizimi.

I dërgohet:

- Të autorizuarit
- QSHQ/Arkivës

Nr.prot. 02-020/05-0039887/22
Podujevë, datë: 07.06.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja f) dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 10.2 të Ligjit për Mbeturina nr. 04/L-060, nenet 16, 19 paragrafi 1.6 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862 dhe nenin 2.1 të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Territorin e Komunës së Podujevës nr. 01-006-16407, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E DRAFT PLANIT KOMUNAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 1

Ngritet Grupi punues për hartimin e draft Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, në këtë përbërje:

1. **Marigona Lahu**, Nënkryetare e Komunës, kryesuese
2. **Bahri Selimi**, U.D. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, anëtar
3. **Leutrim Krasniqi**, U.D. Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, anëtar
4. **Besnik Mulliqi**, U.D. Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, anëtar
5. **Rizah Muçolli**, zyrtar për mbrojtje të mjedisit dhe menaxhim të mbeturinave, anëtar
6. **Fidan Ajvazi**, U.D. menaxher i KR "Pastrimi" njësia në Podujevë, anëtar
7. **Bashkim Osmani**, përfaqësues i komunitetit të bizneseve lokale, anëtar
8. **Hajriz Berisha**, ekolog, anëtar

Neni 2

Grupi punues draftin e Planit për menaxhimin e mbeturinave e harton në bashkëpunim me strukturat relevante dhe institucionet profesionale, duke u mbështetur në standardet e përcaktuara ligjore.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Nr.Prot. 02-20/04-0039884/22
Podujevë, datë: 01.06.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenin 16 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

Ndalohet ngasja e motoçikletave, biçikletave, trotineteve elektrike dhe mjeteve tjera të ngjashme brenda hapësirës së Sheshit/Bulevardit të qytetit.

Neni 2

Masa e ndalimit të ngasjes së mjeteve sipas nenit 1 bëhet për shkak të pengimit të qarkullimit të lirë të qytetarëve në Sheshin/Bulevardin e qytetit dhe me qëllim të parandalimit të çfarëdo forme të rrezikimit apo të lëndimit të qytetarëve, si dhe të evitimit të ndonjë dëmi eventual.

Neni 3

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Drejtoria e Inspeksionit, në bashkëpunim dhe koordinim me Policinë e Kosovës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:
Drejtoria të cekura
Policisë së Kosovës-Stacionit Policor Podujevë
Zyrës për Marrëdhënie me publikun dhe Informim
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-016/01-0042163/22
Podujevë, datë: 08.06.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 52 paragrafi 1.1 të Ligjit për Zyrtarët Publik nr.06/L-114, nenin 4 të Rregullores (QRK) nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil dhe nenin 16 dhe 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës të datës 08.06.2022, të Drejtoreshës së Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, nxjerr:

VENDIM PËR TRANSFERIM TË PËRKOHSHËM

I

z.Bujar Gimolli, zyrtar i lartë në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim në kuadër të Zyrës së Kryetarit, transferohet përkohësisht, në interes të institucionit, në punë dhe detyra të tjera të punës brenda shërbimit civil të Komunës, në pozitë ekuivalente të të njëjtës kategori në kuadër të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

II

Transferimi i të përmendurit bëhet për shkak të nevojave dhe vëllimit të madh të punëve në kuadër të Drejtorisë së pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

III

I përmenduri gjatë periudhës së transferimit përfiton pagën me komponentët e saj më të lartë ndërmjet pagës së pozitës të mëparshme dhe asaj në të cilën transferohet.

IV

Pas përfundimit të afatit të transferimit të përkohshëm nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme

V

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa zbatimin e vendimit e bën Zyra e Personelit në koordinim me Drejtorinë Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

I dërgohet:


Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë

Zyrës së personelit

Të transferuarit

QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-111/01-0042699/22
Podujevë, datë: 08.06.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18 , në kërkesë të Drejtoreshës së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë të datës 09.06.2022, jap këtë:

AUTORIZIM

I.

znj. Blerta Plakolli, zyrtare në kuadër të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë autorizohet për nënshkrimin e Kopjeve të Planit në kuadër të Drejtorisë së cekur, si dhe të deponojë nënshkrimin në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë-QSHQ me qëllim të vulosjes së tyre.

Nënshkrimi i të autorizuarës

II.

Autorizimi jepet për kohë të pacaktuar dhe vlen deri në revokimin e tij.

I dërgohet:

- DPKGJ
- Të autorizuarës
- QSHQ/Arkivës

Nr.prot. 02-020/05-0043487/22
Podujevë, datë: 09.06.2022





KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenet 16, 61 paragrafi 1.9 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.01/172-400, në rekomandim të datës 09.06.2022 të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-020/04-0002690/22, të datës , 13.01.2022, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

1.z.Argjend Rrahmani fermer nga fshati Balloc Komuna e Podujevës, mbështetet me mjete financiare në shumë 500 €.

2. Subvencionimi bëhet me qëllim të mbështetjes financiare për hapjen e një pusi për sigurimin dhe furnizimin e fermës së pulave me ujë.

Neni 2

Mbështetja financiare bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të shpeztarisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Mjetet buxhetore sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe përmes bankës barten në llogarinë e fermerit.

Neni 4

Zbatimin e Vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/03-0043484/22
Podujevë, datë: 09/06/2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Balliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës nr.04/L-032, nenit 5 shkronja d) të Ligjit për arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenit 9 paragrafët 1 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 19 parag.1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas Rekomandimit të Komisionit vlerësues, Kryetari i Komunës, merr:

VENDIM

PËR EMËRIMIN E DREJTORIT/ESHËS TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT- SHFMU " XHELADIN REKALIU " NË PODUJEVË

Neni 1

znj, **Arjeta Bashota**, me nr. personal të letërnjoftimit [REDACTED] me vendbanim në Podujevë, e kualifikuar Master -Shkenca të Biologjisë, emërohet;

Drejtoreshë e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Xheladin Rekaliu" në Podujevë.

Neni 2

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e drejtoreshës të emëruar sipas këtij vendimi, caktohen me kontratë të punës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;
Drejtorisë së Arsimit-DKA
Të emëruarës përmes DKA-së
QSHQ/Arkivit*

Nr. prot. 02-020/02-0043461/22
Podujevë, datë: 10. 06. 2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 8 dhe 13, të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-020/04-0002690/22, të datës 13.01.2022, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere dhe në kërkesë nr.prot 06-400/04-0044356/22, të datës 13.01.2022 Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE

Neni 1

z.Agron Fusha, nga Podujeva, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore si dhe pamundësisë për mbulimin e shpenzimeve mjekësore dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor i jepet ndihmë financiare në shumë 2,000.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/03-0045537/22
Podujevë, datë, 14/06/2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 17 shkronja a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenet 16, 19 paragrafi 1.1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, merr këtë:

V E N D I M

Neni 1

Ngritet Ekipi komunal për koordinimin dhe ndërmarrjen e veprimeve në funksion të hartimit të Strategjisë për Zhvillim Lokal të Komunës së Podujevës për periudhën 2023-2025, në këtë përbërje:

znj. Marigona Lahu , <i>Nënkryetare e Komunës,</i>	<i>koordinatore</i>
z. Hilmi Hoxha , <i>Kryesues i Kuvendit,</i>	<i>anëtar</i>
znj. Antoneta Ejupi , <i>Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës,</i>	<i>anëtare</i>
z. Fatlum Osmani , <i>Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave,</i>	<i>anëtar</i>
z. Avni Fetahu , <i>Drejtor i Drejtorisë së Arsimit,</i>	<i>anëtar</i>
z. Driton Veliu , <i>Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,</i>	<i>anëtar</i>
z. Leutrim Krasniqi , <i>Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit,</i>	<i>anëtar</i>
znj. Saranda Stublla , <i>Drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë,</i>	<i>anëtare</i>
z. Pajtim Balaj , <i>Drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit,</i>	<i>anëtar</i>
z. Bahri Selimi , <i>Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit,</i>	<i>anëtar</i>
z. Besnik Mulliqi , <i>Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit,</i>	<i>anëtar</i>
z. Fatmir Rudari , <i>Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,</i>	<i>anëtar</i>
z. Vigan Salihu , <i>Drejtor i Drejtorisë Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik,</i>	<i>anëtar</i>

Neni 2

Ekipi komunal sipas nenit 1 të këtij vendimi do të koordinojë punët dhe aktivitetet si dhe do të ndërmarrë veprime në funksion të hartimit të Strategjisë për Zhvillim Lokal të Komunës së Podujevës për periudhën 2023-2025.

Neni 3

Ekipi për punët dhe aktivitetet e zhvilluara, Kryetarin e Komunës e informon në formë të shkruar.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-020/04-0045609/22
Podujevë, datë: 14.06.2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 13, 58 shkronja (f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neni 8 parag. 5.2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2018 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna, dhe nenet 14, 16, 59 paragrafi 3.1 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01 -0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Mujë Monolli, lirohet nga pozita e Shefit të Kabinetit të Kryetarit të Komunën e Podujevës.

Neni 2

Lirimi nga detyra e Shefit bëhet për shkak të riorganizimit në kuadër të Kabinetit të cekur si në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të përmendurit
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-020/02-0045759/22
Podujevë, 14.06.2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 13, 58 shkronja (f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neni 8 parag. 5.2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2018 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna, dhe nenet 14, 16, 59 paragrafi 3.1 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01 -0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

znj.Edonë Çitaku, lirohet nga pozita e Zyrtares administrative në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Podujevës.

Neni 2

Lirimi nga detyra e zyrtares bëhet për shkak të riorganizimit në kuadër të Kabinetit të cekur si në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të përmendurës
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-020/02-0045743/22
Podujevë, datë: 14.06.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 6.4 dhe 77 të Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06/L-114, nenin 4 parag. 2.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në Komuna dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

V E N D I M PËR EMËRIMIN E SHEFIT/ES TË KABINETIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS

Neni 1

znj. **Edonë Çitaku**, me profesion ekonomiste-menaxhment biznesi, nga fshati Bajçinë, Komuna e Podujevës, emërohet;

➤ **Shefe e Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Podujevës**

Neni 2

E përmendura në funksionin e cekur emërohet me qëllim të ofrimit të mbështetjes së Kryetarit të Komunës në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësiive.

Mandati i të emëruarës është në kohëzgjatje të mandatit të Kryetarit të Komunës, përveç nëse me vendim të veçantë vendoset ndryshe.

Neni 3

Paga mujore e të emëruarës caktohet sipas legjisllacionit në fuqi, ashtu siç kërkohet në nenin 9 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në Komuna.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Zyra e Personelit.

I dërgohet:
Të emëruarës
Zyrës së personelit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/02-0045744/22
Podujevë, datë 14.06.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

NËNKRYETARJA E KOMUNËS

Bazuar në nenin 60 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, neni 8 parag. 5.2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2018 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna, dhe nenin 63 paragrafët 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01 -0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

znj. Leonora Dërvisholli, lirohet nga pozita Asistente administrative në Zyrën e Nënkyetares së Komunës së Podujevës.

Neni 2

Lirimi nga detyra e asistentes bëhet për shkak të riorganizimit në kuadër të Zyrës së Nënkyetares së Komunës.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të përmendurës
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-020/02-0045949/22
Podujevë, datë: 15.06.2022

Nënkyetarja e Komunës
Marigona Lahu





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

NËNKRYETARJA E KOMUNËS

Bazuar në nenet 5 dhe 8 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2018 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna, nxjerr:

VENDIM PËR EMËRIMIN E ASISTENTIT ADMINISTRATIV NË ZYRËN E NËNKRYETARES SË KOMUNËS

Neni 1

z.Gent Jetullahu, me kualifikim Fakulteti Komunikim Masiv–Dega Produksion, nga Podujeva, emërohet;

➤ **Asistent administrativ në Zyrën e Nënkyetares së Komunës së Podujevës**

Neni 2

I përmenduri në funksionin e cekur emërohet me qëllim të ofrimit të mbështetjes administrative teknike të Nënkyetares së Komunës në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësisive.

Mandati i të emëruarit është në kohëzgjatje të mandatit të Nënkyetares së Komunës, përveç nëse me vendim të veçantë vendoset ndryshe.

Neni 3

Paga mujore e të emëruarit caktohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Zyra e Personelit.

*Idërgohet:
Të emëruarit
Zyrës së personelit
QSHQ/Arkiviti*

Nr. prot. 02-020/02-0045953/22
Podujevë, datë: 15.06.2022

Nënkyetarja e Komunës
Marigona Lahu





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 9.1 dhe 13.2), 3) të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-020/04-0002690/22 të datës 13 janar 2022, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere merr:

VENDIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE NË GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

Neni 1

Tetëdhjetëeshtatë (87) personave në gjendje të rëndë shëndetësore dhe sociale-ekonomike u jepet ndihmë financiare në shumë të përgjithshme 10,900.00€, sipas shumave individuale të paraqitura në listat e rekomanduara nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 3

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/03-0046536/22
Podujevë, datë 16.06.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.06-400/04-0044476/22 të datës 13.06.2022 të OJQ-Shoqëria Kulture Artistike “Flaka e Llapit”, të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ- SHOQËRIA KULTURORE ARTISTIKE “FLAKA E LLAPIT”

Neni 1

Ojq-Shoqëria Kulture Artistike “Flaka e Llapit”, për mbulimin e shpenzimeve të transportit për pjesëmarrje në festivalin e Unionit Mbarëkombëtar “Sofra Dardane”, në qytetin Bajram Curr, mbështetet me mjete financiare, në shumë 450.00 €.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e Ojq-Shoqëria Kulture Artistike “Flaka e Llapit”.


Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-400/03-0046540/22
Podujevë, datë 16.06.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 6.4 dhe 77 të Ligjit për Zyratë Publik nr. 06/L-114, nenin 4 parag. 2.3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në Komuna dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

VENDIM PËR EMËRIMIN E ZYRTARES ADMINISTRATIVE

Neni 1

znj. **Leonora Dervisholli**, Studente e Fakultetit të Gjuhës Shqipe, nga fshati Obrançë Komuna e Podujevës, emërohet;

➤ **Zyrtare administrative në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës**

Neni 2

E përmendura në funksionin e cekur emërohet me qëllim të ofrimit të ndihmës teknike administrative dhe mbështetjes së Kryetarit të Komunës në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësiive.

Mandati i të emëruarës është në kohëzgjatje të mandatit të Kryetarit të Komunës, përveç nëse me vendim të veçantë vendoset ndryshe.

Neni 3

Paga mujore e të emëruarës caktohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Zyra e Personelit.

I dërgohet:
Të emëruarës
Zyrës së personelit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/02-0046544/22
Podujevë, datë: 16.06.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

A U T O R I Z I M

Autorizohet z.Driton Veliu, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural derisa z.Fatmir Rudari, Drejtor i Drejtorisë së cekur të kthehet nga pushimi.

Nr.prot. 02-020/05-0046946/22
Podujevë, datë: 16.06.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.prot.02-020/04-0047429/22 të datës 17.06.2022 të proceduar nga Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit të datës 15.06.2022, merr:

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT Nr.Prot 02-020/04-0033920/22

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet vendimi nr. prot 02-020/04-0033920/22 i datës 13 maj 2022, Për Themelimin e Komisionit Vlerësues Për Shqyrtimin e Aplikacioneve Për Financim Publik të OJQ-ve për Organizimin e Aktiviteteve Rinore/Kulturore në Komunën e Podujevës, dhe atë;

znj.Fatmire Fusha emërohet në cilësinë e Kryesueses së Komisionit në vend të **z.Rexhep Zeka**, i cili zëvendësohet për shkak të ofrimit të dorëheqjes nga përbërja e Komisionit të cekur.

Neni 2

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe është pjesë përbërëse e vendimit nr.prot.02-020/04-0033920/22 të datës 13 maj 2022 .

I dërgohet:

*Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit -DKRS
Anëtarëve të Komisionit(përmes DKRS)
QSHQ/Arkivit*

Nr.prot. 02-020/04-0047598/22
Podujevë, datë 17.06.2022



**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.prot.02-400/04-0048476/22 të datës 21.06.2022, të OJQ Shoqata e Peshkatarëve Sportiv dhe Rekreativ “SH.P.S.R Batllava”, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 1

OJQ Shoqata e Peshkatarëve Sportiv dhe Rekreativ “SH.P.S.R Batllava”, për pjesëmarrje në garën komunale-gara me tapë në Liqenin e Batllavës, mbështetet me mjete financiare në shumë 300.00 €.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ “SH.P.S.R Batllava”.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-400/03-0048808/22
Podujevë, datë, 21.06.2022



Kryetari i Komunës
Shpetim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 9.1 Ligjit për Eficiencë të Energjisë nr.04/L-016, në pajtim me Ligjin për Energji nr. 05/L-181, dhe nenin 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.01-020/01/01-0050862/18, si dhe në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Komunës së Podujevës dhe GIZ-it GmbH nr.prot.02-350/05-0013787/22, dt. 24.02.2022, merr:

V E N D I M **PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT** **PËR ENERGJI DHE KLIMË**

Neni 1

Për hartimin e Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë për Komunën e Podujevës, formohet grupi punues, në përbërje:

1. Rizah Muçolli - kryesues, *Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit*
2. Musli Kutleshi - anëtar, *Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit*
3. Ymer Hoti - anëtar, *Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural*
4. Halit Vërshefci - anëtar, *Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale*
5. Ardian Emini - anëtar, *Drejtorja e Arsimit*
6. Afrim Mulliqi - anëtar, *Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit*
7. Vedat Muçolli - anëtar, *Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit*
8. Memli Gashi - anëtar, *Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik*
9. Hamide Aliu- anëtare, *Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural*
10. Xhevrie Beqiri - anëtare, *Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim*
11. Albert Ajvazi - anëtar, *Drejtorja e Administratës*
12. Meral Hallaqi - vëzhguese nga GIZ-i

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e grupit punues:

- Mbështetë dhe ndihmon përgatitjen e draftimit të Hartimit të Planit të Veprimit për Energji dhe Klimë, ofrimin e të gjitha të dhënave të objekteve komunale, transportit komunal, ndriçimit publik, numrin e banorëve etj. që janë të nevojshme për ofruesin e shërbimit i cili do të zgjidhet nga Zyra e Prokurimit, ndërsa të dhënat që kanë të bëjnë me sektorin rezidencial dhe bizneseve (konsumi i energjisë elektrike për amvisëri, energjisë për ngrohje) transporti privat, bujqësisë, emetimet e gazrave serë, do të mblidhen nga ofruesi i shërbimit, që nevojiten për përgatitjen e draft Planit komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë dhe përgatitjen e listës së projekteve të cilat do të implementohen me masa efijente.

- Ndihmon në përpunimin e të dhënave për planifikim dhe aplikim të masave të planifikuara të Efijencës së Energjisë, aplikimin e burimeve të ripërteritshme të energjisë dhe zvogëlimin e emetimeve të gazrave serë në sektorin e ndërtesave, ndriçimit publik, transportit, shërbimeve publike dhe bujqësisë, si dhe ngritjen e kapaciteteve për monitorim dhe raportim të zbatimit të PKVEK-së.

- Kryen të gjitha procedurat tjera deri në miratimin e PKVEK-së, në Kuvendin e Komunës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit


U dërgohet:

Anëtarëve të Grupit punues përmes DPUMM

QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-020/04-0052135/22
Podujevë, datë: 28.06.2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 16 dhe 61 paragrafi 1.2, të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, me qëllim të caktimit të anëtarëve të Komisionit Vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve të bazuara në Memorandumin e Bashkëpunimit të lidhur mes Komunës së Podujevës dhe UNDP-së, “Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor”, (RELOAD), nxjerr:

VENDIM

Neni 1

Caktohen anëtarët e Komisionit Vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit, dhe atë;

- 1. z. Ardonis Jusufi**, zyrtar i të hyrave financiare - Drejtorja e Buxhetit dhe Financave, anëtar
- 2. z. Memli Gashi**, zyrtar për regjistrimin e bizneseve -Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, anëtar.
- 3.znj.Liridona Rrahmani**, zyrtare për informim dhe monitorimin e mediave- Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, caktohet anëtare rezervë.

Neni 2

Anëtarët e cekur më lartë kanë për obligim që të bëjnë vlerësimin e projekt propozimeve në bazë të kriterëve të paraqitura sipas thirrjes publike të programit RELOAD për organizatat e shoqërisë civile, si dhe për punët dhe përgjegjësitë tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, për realizimin e tij kujdesen anëtarët e komisionit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit
Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave
Zyrës së UNDP-së
Arkivit

Nr. Prot 02-020/04-0052333/22
Podujevë, datë 28.06.2022



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi